

**URDHËR**  
**Nr. 190, datë 13.12.2013**

**PËR KONTROLLIN E DISIPLINIMIT E NËNKONTRAKTIMIT TË SË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË LEJES MINERARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 18.9.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë”, si dhe marrëveshjeve koncesionare në fushën minerare, të miratuara me akte ligjore e nënligjore, nisur nga situata e konstatuar në terren nga grupet e kontrollit, me qëllim rritjen e shkallës së kontrollit dhe sigurisë në punë në veprimtaritë minerare,

**URDHËROJ:**

1. Zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit të minierave apo zonave të veçanta të tyre, të përfituara konform parashikimeve të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, mund të procedojnë me nënkontraktimin e së drejtës së shfrytëzimit, vetëm me miratim paraprak nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI).

2. Në ato raste kur në bazë të marrëveshjeve të posaçme koncesionare për zonat minerare, të miratuara me akte ligjore e nënligjore, parashikohet e drejta e koncesionarit të nënkontraktujnë subjekte të treta për realizimin e projektit, objekt i marrëveshjes, nënkontraktori përzgjidhet nga koncesionari, duke respektuar parashikimet ligjore në fuqi, me kusht që përpara nënshkrimit të marrëveshjes nënkontraktore, koncesionari duhet të kërkojë miratimin paraprak të MEI-t.

3. Për nënkontraktorët e përzgjedhur përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri, zotëruesit e lejes minerare të shfrytëzimit, sipas pikës 1, dhe koncesionarët që kanë përfituar lejet e shfrytëzimit, mbi bazën e marrëveshjeve të posaçme sipas pikës 2, janë të detyruar të kërkojnë pranë MEI-t, miratimin për nënkontraktorin e përzgjedhur, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

4. Kërkesa për miratimin e nënkontraktorit sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri, duhet të shoqërohet me dokumentacionin që provon kapacitetin ligjor, teknik e financiar të nënkontraktorit, në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara për zotëruesin e lejes minerare të shfrytëzimit.

5. Nëse zotëruesit e lejeve minerare nuk kërkojnë dhe nuk marrin miratimin e nënkontraktorëve, sipas parashikimeve më sipër nga ana e MEI-t do të merren masa administrative deri në revokimin e lejes minerare.

6. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore duhet të verifikojë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë urdhër gjatë miratimit të planit vjetor të zotëruesit të lejeve minerare. Në rast se konstatohet se zotëruesi i lejes minerare nuk ka kërkuar dhe nuk ka marrë miratimin e nënkontraktorit, sipas parashikimeve të këtij urdhri, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk miraton planin vjetor të zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Minierave në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Reparti i Inspektim-Shpëtim Minierave.

Ky urdhër hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË**  
**Damian Gjiknuri**